

INFORMACIONE
PER PRINDER

Lëndimet e kokës/ Tronditjet e trurit



Stacioni i emergjencës Spitali i fëmijëve Zürich

Telefoni me pagesë për këshillime: 0900 266 71 1

Ju do të duhej të vini re tek fëmija juaj në 24 orët e ardhshme shenjat vijuese:

- 1) Dhimbje koke:** Është e mundur, që fëmija juaj të ketë dhimbje të lehta koke. Porse këto do të duheshin të humbin pas dhënies së ndonjë mjeti kundër dhimbjeve me dozim sipas moshës (p.sh. Panadol).
- 2) Vjellja:** Eventualisht fëmija juaj ka përzjerje në bark, por nuk vjell. Po që se vjell, vizitoni me të menjëherë një mjek.
- 3) Sjellja:** Fëmija juaj do të duhej të sjellët si gjithmonë. Shenjat, që diçka nuk është në rregull do të ishin p.sh. hutimi, nervozizmi, nuk donë të ha e të pi.
- 4) Lodhja:** Është e mundur, që fëmija juaj është më i lodhur se zakonisht. Për deri sa nuk vjell dhe sjellët normalisht, ju nuk duheni të merakoseni për këtë arsye. Jepini atij pak qetësi.

Shkoni prapë në spital, nëse

- Fëmija juaj është i hutuar apo sillet në mënyrë të pazakontë
- Fëmija juaj ankohet për dhimbje të forta koke, të cilat nuk zhduken pas dhënies së mjeteve kundër dhimbjes.
- Fëmija juaj vjellë
- Fëmija juaj ankohet për dobësi apo ndjenja të mpirjes
- Apo ju jeni të brengosur për çfarëdo arsye tjetër.

Në ditët pas lëndimit të kokës është e mundur që fëmija juaj të ankohet për:

- Dhembje të lehta koke
- Çrregullime të përqendrimin n Lodhje
- Çrregullime të gjumit

Nëse këto simptome nuk zhduken Brenda 48 orëve, ju do të duheni të e kontaktoni mjekun e fëmijës apo shtëpisë.

Ju do të duheni të e mbani fëmijën tuaj larg aktiviteteve sportive, deri sa të i tregon këto simptome! Porsa fëmija juaj ankohet për dhimbje koke, ai duhet të shtrihet e të pushoj.
